



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

RREGULLORE

PËR

PLANIFIKIMIN, HARMONIZIMIN DHE HARTIMIN E DOKUMENTEVE  
STRATEGJIKE NË MINISTRINË E MBROJTJES DHE  
FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes

Nr. 129, datë 31. 1. 2024

## **I. HYRJE**

Udhëzuesi për Planifikimin në Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) ka për qëllim të garantojë harmonizimin e dokumenteve strategjike dhe politikave të MM-së dhe FARSH-it ndërmjet tyre, si dhe me dokumentet e miratuara nga institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë.

## **II. QËLLIMI**

Rregullorja e procesit të planifikimit është një rregullator që ka si qëllim të përcaktojë qartësisht procesin e planifikimit, hierarkinë e dokumenteve strategjike, autoritetin vendimmarrës, menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e procesit dhe përafrimin e tij me proceset e planifikimit, afatet kohore dhe procesin e hartimit të draft dokumenteve të planifikimit, nivelin, parimet, llojet e planeve/programeve dhe lidhjet e tyre me buxhetin në nivel strategjik në MM dhe FARSH.

## **III. ZBATUESHMËRIA**

Rregullorja e procesit të planifikimit në institucionin e MM dhe strukturat vartëse të saj, si dhe FARSH-it ka si objektiv të ofrojë udhëzime konceptuale për procesin e planifikimit në FARSH.

## **IV. PËRKUFIZIMET**

Termat e përcaktuara me këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1. Procesi i planifikimit në MM është një proces ciklik dhe një mjet për zhvillimin efektiv dhe efikas të aftësive/forcave për të siguruar nivelin maksimal të zhvillimit dhe kryerjes së veprimeve për përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.
2. Politika e mbrojtjes dhe sigurisë është drejtimi dhe përmbajtja e politikave dhe veprimeve të autoriteteve shtetërore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe merret me përcaktimin dhe zhvillimin e qëllimeve kombëtare në këtë fushë dhe marrëdhëniet e tyre me shoqërinë, duke përcaktuar llojet dhe nivelet e aftësive të nevojshme, si dhe identifikimi i qasjeve dhe prioriteteve në lidhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare.
3. Dokumentet e referuara janë: Kushtetuta e RSH-së, ligjet dhe aktet e tjera normative, dokumentet strategjike të NATO-s dhe BE-së, strategjitë apo llojet e tjera të politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria.
4. Burimet e Mbrojtjes nënkuptojnë pajisje, hapësirë dhe objekte, si dhe mjete financiare për zhvillimin, mbështetjen dhe mirëmbajtjen e Forcës.

## **V. PARIMET**

Kjo rregullore është hartuar mbi bazën e parimit të përgjithshëm të kontrollit demokratik të Forcave të Armatosura dhe parimeve të tjera, si më poshtë:

1. Transparencë dhe llogaridhënie për të garantuar që proceset e vendimmarrjes të bazohen në rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, akte të tjera normative dhe të jenë profesionale.
2. Vazhdimësia për të siguruar përafrimin e planifikimit dhe stabilitetin e zhvillimit brenda politikave të mbrojtjes dhe sigurisë.
3. Fleksibilitet për të mundësuar, madje edhe për të nxitur ndryshime konstruktive në koncepte, kurrikula, doktrina, në rast ndryshimi të rrethanave, mjedisit apo burimeve të disponueshme.
4. Konformiteti për të siguruar që udhëzimet e politikave të mbrojtjes janë zhvilluar dhe janë harmonizuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha nivelet dhe me të gjitha dokumentet përkatëse.
5. Përballueshmëria që mundëson arritjen e një ekuilibri ndërmjet nevojës për të zhvilluar aftësitë dhe burimet në dispozicion të FARSH-it.
6. Balancim që përpiket të arrijë raportin optimal në zhvillimin e një spektri të gjerë të kërkesave të ndryshme të aftësive të FARSH-it.
7. Llogaridhënia menaxheriale, e cila tregon se drejtuesit e të gjitha niveleve kanë role dhe përgjegjësi në vendimmarrje dhe janë të harmonizuar në arritjen e objektivave dhe qëllimeve.

## **VI. DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE TË PLANIFIKIMIT SHTETËROR KOMBËTAR**

Dokumentet e politikave strategjike janë dokumentet kryesore planifikuese në nivel kombëtar, të cilat mbështesin qëllimet strategjike dhe objektivat strategjike në RSH.

1. Kushtetuta, ligjet, marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe dokumentet përkatëse të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është anëtare ose ka marrëdhënie bashkëpunimi janë burim për hartimin e politikës së mbrojtjes dhe sigurisë.
2. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), në përmbushje të misionit kushtetues për ruajtjen e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale të RSH-së janë përgjegjëse për hartimin e një sërë strategjish dhe planesh sektoriale, si dhe vazhdimisht kontribuojnë në strategji të tjera të karakterit ndërinstitucional. Përfshirja në mbështetje në këtyre strategjive detyron Ministrinë e Mbrojtjes të parashikojë veprime të detajuara në përmbushje të masave të parashikuara, të cilat ndërmerren nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH-it.
3. Dokumentet strategjike që zbatohen nga Ministria e Mbrojtjes për të cilat është përgjegjëse ose që dokumenti është drejtpërdrejt i lidhur me misionin e FARSH-it janë, si më poshtë:
  - a) **Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK)** është dokumenti kryesor ku cilësohen aspekte të ndryshme të sigurisë dhe mbrojtjes të vendit tonë, ku tregohet se si Republika e Shqipërisë

i ofron siguri qytetarëve të saj. Institucioni drejtues për përgatitjen e dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në koordinim me ministrinë e linjës. Për hartimin e dokumentit, Ministria e Mbrojtjes dhe FARSH-i ofrojnë kontributin dhe ekspertizën e tyre në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Dokumenti aktual i SSK-së që kemi në zbatim është miratuar me ligjin nr. 103/2014.

**b) Strategjia Ushtarake (SU)** është dokumenti themelor që jep parimet dhe konceptet kryesore për zhvillimin, përdorimin dhe drejtimin e FARSH-it. Ajo bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Ministria e Mbrojtjes është institucioni përgjegjës për përgatitjen e SU-së. Dokumenti i SU-së që kemi aktualisht në zbatim është miratuar me ligjin nr. 72/2015.

Objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, skenarët e rishikimit strategjik të mbrojtjes, si dhe koncepti strategjik i NATO-s, përkthehen në kapacitete ushtarake dhe plane orientuese, në këtë dokument, i cili është miratuar me ligjin nr. 121/2015. Ministria e Mbrojtjes përgatit PAZHFA-në.

## **VII. DOKUMENTET KRYESORE STRATEGJIKE TË PLANIFIKIMIT NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË**

Dokumentet kryesore strategjike të planifikimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (që janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me dokumentet strategjike dhe planifikuese të MM-së dhe FARSH-it), janë:

### **1. Rishikimi i Strategjisë së Mbrojtjes së RSH-së.**

RSM-ja përshkruan interesat strategjike kombëtarë dhe politikat e mbrojtjes të RSH-së, trajton rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, evidenton sasinë dhe cilësinë e kapaciteteve që duhet të disponojnë FARSH, sipas skenarëve më të mundshëm të përdorimit të tyre nëpërmjet argumentimit analitik të rolit të tyre në mjedisin e ri të sigurisë, për të bërë të mundur funksionimin si një forcë e mirëpajisur, e mirëtrajnuar dhe e aftë profesionalisht, për të realizuar misionin kushtetues.

### **2. Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura (PAZHFA 2016-2025).**

Plani Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura 2016-2025 përkthen objektivat e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Strategjisë Ushtarake, skenarët e rishikimit strategjik të mbrojtjes 2013, si dhe konceptin strategjik të NATO-s në kapacitete ushtarake, duke tentuar plane orientuese në pikëpamje të kohës dhe burimeve të disponueshme. Ky dokument përcakton drejtimet e zhvillimit të Forcave të Armatosura (FA) dhe orienton ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për përmbushjen e misionit kushtetues dhe mbrojtjen kolektive mbi bazën e burimeve, në harmoni me Sistemin e Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s.

Hartimi i PAZHFA 2016-2025 është bazuar në dokumentet kryesore të sigurisë kombëtare, (Kushtetutën e RSH-së, ligjin nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare (SSK), Strategjinë Ushtarake (SU) dhe Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM), dhe të Aleancës (Konceptin Strategjik dhe Paketën e Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s).

### **3. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022 - 2030 (SKZHI).**

Ky është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritimit evropian. Kryeministria në koordinim me ministrinë e linjës përgatit dhe shqyrton SKZHI. SKZHI 2022 - 2030 është aprovuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 11.5.2016.

### **4. Strategjia e Mospërhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë dhe planin e saj të veprimit.**

Strategjia bazohet në parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, Strategjisë Ushtarake, Strategjisë Kombëtare të Antiterrorizmit, Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufijve etj. Gjithashtu kjo strategji është pjesë integrale e kuadrit të strategjive kombëtare dhe plotëson mekanizmat e përgjigjes për menaxhimin e krizave dhe emergjencave. Ministria e Mbrojtjes është institucioni përgjegjës për Strategjinë e Mospërhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë dhe planin e saj të veprimit, e cila është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 22.01.2020.

### **5. Plani Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit.**

Përshkruan supozimet e planifikimit, konceptet operationale, reagimet dhe veprimet që kërkohen në rast të një incidenti ajror ose detar, duke përshkruar proceset dhe metodologjinë për zbatimin dhe menaxhimin e përpjekjeve kombëtare të përgjigjeve ndaj aksidenteve ajrore dhe detare. Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për administrimin e përgjithshëm të shërbimit të kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe zbatimin e politikave në këtë fushë. Ky dokument është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 13.11.2019.

### **6. Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC).**

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile është një nga dokumentet kryesore politike të qeverisë shqiptare në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile. Planet për emergjencat civile hartohen bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, kapacitetet e mbrojtjes civile, gjetjet e reja të ekspertëve, si edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive.

PKEC-ja është dokumenti themelor për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër. Dokumenti përmbledh informacione, në të cilin janë përshkruar faktorët më të rëndësishëm dhe rolet e të gjitha institucioneve dhe të strukturave të përfshira në të gjitha fazat e menaxhimit të emergjencave

civile. Ky dokument është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 3 dhjetor 2004.

#### **7. Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror.**

Është një prej dokumenteve strategjike që shërben për të adresuar parandalimin dhe zvogëlimin e riskut. Dokumenti është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 168, datë 24.03.2023.

#### **8. Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 dhe Plani i Veprimit.**

Është dokumenti që do të drejtojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme të Shqipërisë për menaxhimin e riskut të fatkeqësive në një mënyrë tërësore dhe gjithëpërfshirëse. Dokumenti është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 22.02.2023.

### **VIII. DOKUMENTET STRATEGJIKE DHE PLANIFIKUESE NË MM DHE FARSH**

Dokumentet strategjike dhe planifikuese në MM/FARSH bazohen në ligjet dhe aktet tjera normative, politikat, konceptet, strategjitë, doktrinën, memorandum-marrëveshjet dypalëshe dhe aktet e tjera të miratuara nga ministri i Mbrojtjes, sekretari i përgjithshëm dhe SHSHPPFA janë autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planifikuese në MM dhe FARSH.

#### **Dokumentet kryesore strategjike në MM dhe FARSH janë:**

##### **1. Ligjet dhe aktet normative.**

Rregulloret dhe udhëzimet administrative janë dokumente që përcaktojnë rregulla të bazuara në ligjet e shtetit.

##### **2. Dokumenti i Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë (RSM).**

Ky është dokumenti udhërrëfyes për planifikimin e Mbrojtjes, i cili rekomandon kapacitetet e nevojshme për realizimin e misionit kushtetues të mbrojtjes së vendit, si dhe mbrojtjes kolektive. Dokumenti i RSM-së që kemi aktualisht në zbatim është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 25.9.2019.

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes është një proces ciklik i hapur dhe transparent që zhvillohet çdo 5 vjet gjatë hartimit të Planit Afatmesëm të Zhvillimit. Përdoret për të vlerësuar dhe për të rishikuar përshtatshmërinë dhe efikasitetin e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes, për të vlerësuar nëse transformimi i sistemit të mbrojtjes është i fokusuar mjaftueshëm në luftimin e kërcënimeve dhe sfidave në mjedisin e sigurisë dhe identifikimin e ndonjë devijim të madh nga qëllimet e caktuara të mbrojtjes.

### **3. Politikat dhe Direktivat e Udhëheqjes.**

Politikat dhe Direktivat e Udhëheqjes në MM dhe FARSH ofrojnë drejtime kyçe dhe prioritete strategjike për të arritur rezultate për një fushë të caktuar.

### **4. Konceptet sektoriale.**

Konceptet e fushave sektoriale janë dokumente që përcaktojnë drejtimit dhe zhvillimin për një fushë të caktuar për të arritur qëllimet kryesore sektoriale.

Dokumentet strategjike sektoriale në Ministrinë e Mbrojtjes për FARSH-in paraqesin fushëveprimin e aktiviteteve të sektorëve të veçantë dhe të rëndësishëm të përcaktuar në dokumentet strategjike dhe synojnë arritjen e qëllimeve dhe objektivave kryesorë të politikave të MM-së, ku në mënyrë të veçantë ndër më kryesoret mund të përmendim:

#### **a) Direktiva e Komunikimit Strategjik.**

Ministria e Mbrojtjes ka një Direktivë të Komunikimit Strategjik (DKS), miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes nr. 801, datë 15.06.2021. DKS-ja bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin për të drejtën e informimit, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë Ushtarake dhe Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, si dhe në udhëzimet e NATO-s në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin strategjik.

#### **b) Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020-2024 dhe plani i saj i veprimit.**

Ky dokument, i përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes, ka për qëllim orientimin e punës për menaxhimin e burimeve njerëzore përgjatë të gjithë ciklit jetësor të personelit, nga rekrutimi, arsimimi, trajnimi, emërimi në detyrë, promovimi në gradë dhe karrierë, deri te dalja në rezervë dhe në pension. Strategjia është miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes me nr. 246, datë 24.02.2020.

#### **c) Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike të MM/FA 2021-2023.**

Duke marrë shkas nga zhvillimi teknologjik, rritja e sasisë dhe vlerës së informacionit elektronik të shkëmbyer në sistemet e komunikimit të informacionit, në Ministrinë e Mbrojtjes është në zbatim Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike të MM/FA 2021 - 2023, qëllimi i së cilës është mbajtja e një mjedisi elektronik të sigurt, elastik e të besueshëm që mbështet sigurinë në MM/FA dhe rrit përfitimet digjitale në interes të misionit dhe detyrave specifike. Aktualisht është në proces hartimi Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike 2024-2028, misioni i së cilës do të vijojë të jetë mbajtja e një mjedisi elektronik të sigurt, të besueshëm që mbështet sigurinë në MM/FA për funksionimin normal të sistemeve të komunikimit dhe të informacionit në interes të realizimit të detyrave.

#### **ç) Strategji të ndryshme sektoriale.**

Gjithashtu, Ministria e Mbrojtjes ka kontribuar në hartimin, por edhe zbaton një sërë strategjish ndërsektoriale, të cilat janë përgjegjësi e ministrive të ndryshme, por që kanë në planet e veprimit masa për realizimin e të cilave nevojitet kontributi i strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, konkretisht:

1. Strategjia e Luftës kundër Terrorizmit;
2. Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit;
3. Strategjia kundër Radikalizmit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm;
4. Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve;
5. Strategjia e Mbrojtjes Gjinore;
6. Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit;
7. Strategjia Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda;
8. Strategjia Kombëtare e Rinisë;
9. Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
10. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.

## **IX. NIVELET DHE PROCESET E VENDIMMARRJES NË MINISTRINË E MBROJTJES**

Vendimmarrja në Ministrinë e Mbrojtjes është e ndarë në tri nivele:

### **1. Drejtimi konceptual ose niveli strategjik.**

Niveli i vendimmarrjes strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes përfshin ministrin e Mbrojtjes, SHSHPFA dhe sekretarin e përgjithshëm të MM-së.

### **2. Koordinimi funksional ose niveli operacional.**

Niveli operativ i vendimmarrjes në Ministrinë e Mbrojtjes përfshin drejtorin e Drejtorisë për Politikën e Mbrojtjes dhe drejtorin e Drejtorisë për Operacionet dhe Stërvitjen. Niveli operativ ekzekutohet në nivelin e njësisë përkatëse organizative të MM-së dhe përfshin zhvillimin e kërkesës për aftësitë mbrojtëse me elemente të aftësisë brenda juridiksionit të saj, planifikimin dhe monitorimin paralel, me qëllim arritjen e një grupi koheziv të aftësive dhe koordinimin ndërmjet palëve të interesuara në zbatimin e projekteve.

### **3. Zbatimi menaxherial ose niveli taktik.**

Niveli i tretë, zbatimi i kapaciteteve mbrojtëse realizohet në nivel të njësisë organizative të Ministrisë së Mbrojtjes. Planifikimi i Mbrojtjes në këtë nivel përfshin planet e zbatimit dhe vlerësimin, si dhe afatin kohor për realizimin e tyre, duke përfshirë shprehjen e kërkesave të planifikuara për burime për njësitë funksionale kompetente të MM-së dhe FARSH-it.

## **X. PERIUDHA DHE PROCESI I PLANIFIKIMIT NË MM DHE FARSH**

### **1. Periudhat e planifikimit në MM dhe FARSH ndahen në:**

- a) Planifikimi Afatgjatë, një periudhë kohore nga gjashtë deri në dhjetë vjet;
- b) Planifikimi Afatmesëm, një periudhë kohore nga tre deri në gjashtë vjet;
- c) Planifikimi Afatshkurtër, një periudhë kohore deri në tre vjet.

Dokumentet e Planifikimit Afatgjatë përshkruajnë vetëm vizionin primar të zhvillimit.

## **2. Fazat e planifikimit të Mbrojtjes.**

Planifikimi i mbrojtjes dhe sigurisë është një proces jetese i qëndrueshëm i përbërë nga pesë faza:

- a) Përcaktimi i udhëzimeve të politikave të mbrojtjes;
- b) Planifikimi i aftësive mbrojtëse;
- c) Programimi;
- ç) Zbatimi i planeve;
- d) Vlerësimi i rezultateve të arritura dhe raportimi.